



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë praktike e Gjuhës B (1)

Ngarkesa: 6 kredie: 84 leksione; 84 seminare

Viti / Semestri: Viti I , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor pranë Departamenteve të tjera FGJH

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të paraqesë një hyrje në fillimin e mësimin të gjuhës se huaj në lëndën gjuhë praktike. Lënda synon që studenti të fillojë të marrë njohuritë bazë në gjuhën e huaj italiane duke filluar nga alfabeti, numrat rregullat kryesore të drejtshkrimit dhe leximit saktë në gjuhën italiane. Pastaj do të kalohet në konceptet fillestare të gramatikës, leksikut duke e rritur dora-dorës nivelin.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore dhe strukturat gjuhësore të nivelit A1-A2 të gjuhës italiane që lidhen me problemet fonetike, morfologjike, leksikore të gjuhës italiane, duke trajtuar çështje si kategoritë e emrit, mbiemrit, gjinisë, numrit etj, problemet, që lidhen edhe me përshtatjen e tyre nga aspektet gramatikore.
2. Do të trajtohen çështje që lidhen gjithashtu me elemente kulturore të aspekte të ndryshme të jetës dhe kulturës italiane, elemente, që do shoqërojnë kursin gjatë gjithë kohës së zhvillimit të tij. Dora dorës synohet që të jepen edhe koncepte baze gramatikore të foljes si ndarja në tre zgjedhime, ndarja në folje të rregullta dhe të çrregullta, ndarja në folje kalimtare dhe jokalimtare, foljet ndihmese dhe gjysem ndihmese.
- 3.Do synohet që të mësohet i plotë zgjedhimi i foljeve të rregullta të tre zgjedhimeve.
4. Do të jepen edhe shpjegime të koncepteve të tjera gramatikore të krahasimit të mbiemrit, shkallëve të tij, do të jepen edhe shpjegime për pjesëza ndajfoljore etj.

Rezultatet të pritshme:

Në fund të këtij kursi studenti synon, që të fitojë aftësitë kryesore të gjuhës italiane në lidhje me fonetikën, morfologjinë dhe leksikun dhe të jetë në gjendje të kuptojë, të lexojë dhe të flasë në gjuhën italiane në nivelin A1-A2.